




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.209/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Poterqoi – Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Mazreku”SH.P.K.– Malishevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me këndin e lodrave për Çerdhen e fëmijëve Tulipanët në Rahovec”, me nr. të prok: 632-22-4060-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Rahovec”, më datën: 29.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Mazreku”SH.P.K.– Malishevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me këndin e lodrave për Çerdhen e fëmijëve Tulipanët në Rahovec”, me nr. të prok: 632-22-4060-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Rahovec”.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me këndin e lodrave për Çerdhen e fëmijëve Tulipanët në Rahovec”, me nr. të prok: 632-22-4060-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Rahovec”, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Mazreku”SH.P.K.– Malishevë, i aprovohet e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues: “Mazreku”SH.P.K.– Malishevë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Mazreku”SH.P.K.– Malishevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.06.2021 me nr. 209/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me këndin e Lodrave për Çerdhen e fëmijëve Tulipanët në Rahovec”, me nr. të prok: 632-22-4060-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Rahovec”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 59 , dhe 65 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.06.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ne anën teje Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin ekonomik i cili ka ofertuar me çmim prej 8 000.00€, përderisa vet AK- Komuna Rahovec, si vlere te parashikuar te kontratës ka përcaktuar vlerën prej 5 000.00€. Ky veprim paraqet shkelje te nenit Neni 62, i LPP-se, “Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit”, ku përveç arsyeve tjera paragrafi 2.1 shprehimisht përcakton qe : “ të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”, rrjedhimisht AK duhet ta anuloi aktivitetin e prokurimit. Përfundimisht, ne mbështetje te asaj qe u përshkrua sime larte propozimi ynë për AK- Komuna Rahovec është qe ketë procedure te prokurimit ta anuloi ne tërësi dhe ne rast te ri tenderimit te aplikoi kërkesa relevante dhe proporcionale ne raport me natyrën e aktivitetit te prokurimit dhe kërkesat të jenë të qarta për ofertuesit e mundshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, “Mazreku”SH.P.K., të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe kjo procedurë e prokurimit te anulohet ne tërësi.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.06.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 29.06.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “Mazreku”SH.P.K.–Malishevë ,me datë: 22.06.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.07.2022, me praninë e palëve në procedurë ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Mullabazi i cili deklaroj: Përgjigjen e kom dhanë me date 29.06.2022 ku AK KK Rahovec nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues për anulimin e Aktivitetit të prokurimit. Ku në raport të Ekspertit thuhet se vlera e parashikuar në këtë aktivitet të prokurimit ka qenë në vlerë prej 5000 euro OE i rekomanduar ka ofertuar çmimin prej 8000 euro AK KK Rahovec është bazuar në rregulloren e KRPP-së ku si provë materiale kërkoj t'ia dorëzoj kryetarit përgjigjen nga eksperti i prokurimit i departamentit të rregullave dhe deklarata e nevojave duke siguruar me dëshmi me shkrim nga ZKF dhe ZKA që mjetet janë për këtë aktivitet të prokurimit. Ka edhe prova materiale e cila i dorëzohet Kryetarit të Panelit gjatë seancës, po ashtu të FTD, OE nuk e ka plotësuar deklaratën për specifikime teknike që është pjesë e draftit të DT nuk e ka dorëzuar deklaratën me shkrim që garanton se pajisjet e ofruara do të jenë me garancion 12 muaj dhe nuk e ka dorëzuar deklaratën për afatin e Liferimit. Po ashtu deklarata nën betim nuk është e nënshkruar nga pronari Afrim Mazreku por është e nënshkruar nga Bashkim Mazreku i cili nuk ka pasur një autorizim paraprak të dorëzuar në ofertë në bazë të interpretimit të KRPP-së, tek pyetje nr. 40 të pyetjet e shpeshta. Kërkojmë nga OSHP, që ankesën e OE ta REFUZOJ si të pa bazuar dhe në si AK TE VAZHDOJM ME NENSHKRUIMIN E KONTRATES për projektin “Furnizim me këndin e Lodrave për Çerdhen e Fëmijëve “TULIPANËT” në Rahovec”.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Bibaj i cili deklaroj: Arsyeja kryesore pse un kam propozuar që ky AK, i prokurimit të anulohet në tersi ka të bëjë me atë se AK kërkesat e kualifikimit përkatësisht disa nga arsyet e eliminimit të OE ankues i ka përcaktuar tek udhëzimet për ofertuesit dhe jo tek fletat e të dhënave të tenderit bahet fjalë për garancionin, deklaratën për garancion si dhe deklarata për liferim të produktit veprimet e tilla me LPP-në, konsiderohen si shkelje të rëndta të LPP-së, dhe një gjë tilla është e ndaluar me nenin 18.3 të RRUOOP-së ku struktura e dosjes së tenderit përbehet nga tri pjesë pjesa A pjesa B dhe pjesa C përderisa pjesa A procedura e tenderimit përbehet nga dy pjesë: Udhëzimet për ofertuesit dhe fletat e të dhënave të tenderit, ku udhëzimet për ofertuesit është një formë standarde që nuk ka nevojë të plotësohet nga AK, zyrtari i prokurimit duhet të plotësojë fletën e të dhënave të tenderit për secilin aktivitet të prokurimit, z. përfaqësues tani në seancë përmes përgjigjes kundrejt raportit përheq që nuk është pajtuar me propozimin tim përveç tjerash ka potencuar se eksperti ka bërë lajthitje duke mos u

bazuar ne ligj përkundrazi un përmes raportit i kam sqaruar dhe trajtuar të gjitha pretendimet dhe shkeljet e renda nga AK dhe aplikimi i kërkesave te kualifikimit jashtë FDT është pikërisht lajthitje për OE te caktuar dhe të interesuar për këtë aktivitet te prokurimit, andaj un si Ekspert përveç qe propozoj qe ky aktivitetin e prokurimit te anulohet si i kundër ligjshëm kërkoj nga OSHP qe ti aplikoj dispozitat e nenit 25 parag. 8 të LPP-së, dhe ta njoftoj KRPP-në me shkeljet ligjore. Unë qëndroj prapa pretendimeve ne tërësi.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket Deklaratës nën Betim, Paneli shqyrtues sqaron se pa të drejtë është bërë eliminimi operatorit ekonomik nga ky aktivitet i prokurimit, ngase autoriteti kontraktues konform nenit 72, ka mundur të kërkoj nga operatori ekonomik që të dorëzoj, plotësoj, sqaroj apo kompletoj informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor.

Autoritetet Kontraktuese gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohen në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj: " Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë..." Po ashtu sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Lidhur me kërkesat e parashtruara për kualifikimin e ofertuesve (të lidhura me nenin 65-70 të LPP-së), AK, gjatë vlerësimit mund të kërkojë nga ofertuesi sqarim të tenderëve, por pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit.(Nenet 59.4 dhe 72 të LPP-së). Me fjalë të tjera, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit, kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që

kërkesat e tilla të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Përveç kësaj, kërkesa nuk do të duhej që të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht kandidatin përkatës. Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë dhe do të kërkojë informacion nga operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, deklaratave, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje

Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket Listës së projekteve të përfunduara, në bazë të dokumentacionit të paraqitur në ofertën e operatorit ekonomik ankues rezulton se ka projekte të mjaftueshme të kërkuara konform kritere minimale të kualifikimit të paraqitura në Dosjen e Tenderit.

Lidhur me pretendimin ankimor për sa i përket diskualifikimit të OE ankues për deklaratën për garancion si dhe deklaratën për liferim të produktit, nuk janë paraqitur tek kriteret minimale të kualifikimit, dhe kjo konform RRUOPP neni 41.12 citon: *“AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.”*, andaj, edhe ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59, 60 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK-Rahovec ”,

1x1 OE - “Mazreku”SH.P.K.–Malishevë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

